



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2020:060619

Datë: 18.02.2025

Numri i dokumentit: 06859174

K.DH.SH.II.nr.656/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit – të kundërpaditurit (më tej: paditësi) N.P.T.SH “Getoari” Sh.P.K me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Sahit Bibaj, ndaj të paditurit - kundërpaditësit (më tej: e paditura) Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Naime Abazi, avokate shtetërore, me objekt kontesti kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarës së të paditurës – kundërpaditëses, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështjet Ekonomike KE.nr.2473/22 të datës 01.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit - kundërpaditësit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështjet Ekonomike KE.nr.2473/22 të datës 01.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështjet Ekonomike, me aktgjykimin KE.nr.2473/22 të datës 01.02.2023 (tani e tutje: “aktgjykimi”) ka vendosur si në vijim:

1. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR padia e paditësit N.P.T.SH “Getoari” Sh.P.K me seli në Prizren, me të cilën ka kërkuar të aprovohet kërkesëpadia e paditësit N.P.T.SH “Getoari” Sh.P.K dhe të detyrohet e paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që paditëses në emër të punëve të filluara përgatitore gjeodezike, dislokim të makinerisë, punëtorëve dhe punëve tjera përgatitore dhe në emër të punimeve të kryera në objektin e kontraktuar, materialeve të dërguara në emër të fitimit të humbur t’i paguaj borxhin në shumën prej 117,269.67 (njëqind e shtatëmbëdhjetëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë Euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent) Euro, me kamatë vjetore 8% në vit, duke filluar nga data e

ekspertizës së ekspertëve e datës 23.10.2017 e deri në pagesën definitive, e tërë kjo në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

2. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PA BAZUAR kërkesëpadia e kundër paditëses/ të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e kundër paditëses ashtu që të detyrohet paditësi N.P.T.SH “Getoari” Sh.P.K që të bëjë kthimin e shumës 66,485.17 (gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë Euro e shtatëmbëdhjetë cent) Euro në emër të pjesës së mbetur të avansit dhe atë me kamatë ligjore 8%.
3. DETYROHET e paditura/ kundër paditësja Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që t’ia kompensojë paditësit N.P.T.SH “Getoari” Sh.P.K shpenzimet procedurale në vlerë prej 6,169.00 (gjashtëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e autorizuar e të paditurës, Avokatura Shtetërore për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike; dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me datë 05.04.2023 Avokatura Shtetërore ka parashtruar plotësim të ankesës me të cilën ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë t’a aprovojë ankesën si të bazuar, ashtu që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditësit, me propozim që ankesa të refuzohet dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i atakuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarës së paditurës – kundërpaditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Paditësi NPTSH “Getoari” Sh.P.K, me seli në Prizren, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e parashtruar gjykatës në datën 03.02.2016, ka kërkuar pagesën e borxhit në shumën prej 117,269.67 Euro me kamatë ligjore nga e paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në emër të punëve të filluara përgatitore gjeodezike, dislokim të makinerisë, punëtorëve dhe punëve tjera përgatitore dhe punimeve të kryera në objektin e kontraktuar. Me padi, paditësi pretendon se me datë 18.11.2009 paditësja me të paditurën/ kundër paditësen kanë lidhur kontratë për kryerje të punëve ndërtimore në ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza në Zonën Industriale Drenas ku paditësi si provë ka paraqitur kontratën me nr. të prokurimit MTI 204/09/096/511. Në pajtim me kushtet e kontratës, komunikimet gojore dhe ato elektronike, paditësi ka filluar ekzekutimin e punimeve, të cilat i ka mbikëqyrur NPN “Plan Kos” me menaxher z. Flamur Lajqi. Me vendimin me nr. Protokolli 1448 të datës 13.05.2010, të nënshkruar nga z. Naser Grajcevc i është lejuar fillimi i punimeve kinse pas eliminimit të

pengesave që janë shkaktuar me fillimin e punimeve ka shtuar më tej paditësi nëpërmjet kërkesëpadisë. Tutje ka deklaruar se pas fillimit të punimeve, në ekzekutimin e tyre janë paraqitur përsëri probleme të cilat paditësja me raport pune i ka evidentuar tek e paditura me nr. Protokolli 3970 me datë 21.09.2010. Pas vështirësive në terren, pengesave në ekzekutim të punimeve dhe pamundësisë së të paditurës për eliminim të këtyre pengesave, e paditura me datë 27.02.2013 e njofton paditësin për shkëputje të kontratës në mënyrë të njëanshme dhe shpreh se të gjitha obligimet e vërtetuara nga organi mbikëqyrës dhe sipas shkresave të projekt menaxherit do të paguhen. Mirëpo, paditësi ka shpreh se pagesa e lartpërmendur nuk është kryer dhe për atë brenda afatit ligjor ka paraqit këtë padi edhe pas tentimeve vazhdimisht për të gjetur një zgjidhje në rrugë jashtëgjyqësore. Paditësi për gjetjen e saktë të shpenzimeve të punëve, makinerive dhe fitimit të humbur ka kërkuar caktimin e ekspertëve nga lëmit përkatëse.

Me datë 07.04.2016 e paditura ka paraqitu kundërpadi ndaj paditësit tani të kundër paditurit NPTSH “Getoari” Sh.P.K me të cilën ka kërkuar aprovimin e kundërpadisë si të bazuar duke e detyruar të kundër paditurin të bëjë kthimin e shumës 66,485.17 (gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë euro e shtatëmbëdhjetë cent) Euro në emër të pjesës së mbetur të avansit dhe atë më kamatë ligjore 8%. Me kundërpadi, i padituri/ kundër paditësi pretendon se sipas kërkesës së kontraktuesit NTSHP “Getoari” duke ju referuar pro faturës nr.155/2009 të datës 18.01.2009 duke u bazuar në Ligjin për Prokurim Publik dhe kushtet e kontratës respektivisht nenin 12 të Kushteve të Veçanta të Kontratës, e paditura/ kundër paditësja ka bërë pagesën e avansit 10% në vlerë prej 90,277.98 (nëntëdhjetëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e nëntëdhjetë e tetë cent) Euro, ku si provë ka prezantuar kërkesën për avans nga paditësi/ i kundër padituri; kërkesën për aprovim të paradhënies prej 10%, pagesën e avansit me nr. të kuponit të shpenzimeve 138269 dhe vendimin për fillimin e punimeve. Për arsye të pengesave dhe problemeve të paraqitura dhe pamundësisë së evitimit dhe zgjidhjes së tyre konform nenit 10 par.1 dhe 2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës për “Lirimin nga përmbushja e kontratës”, vendos të bëjë ndërprerje ligjore të kontratës duke e njoftuar paditësin/ të kundër paditurin për vendimin dhe pamundësinë objektive të realizimit të kontratës. Sipas kundërpadisë punët e kryera sipas kontratës dhe projektit ku vlerësimi për punët e para masës dhe parallogaritë ishte 23,792.81 (njëzetetremijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy euro e tetëdhjetë e një cent) Euro, e që me këtë gjendje të punëve të realizuara është pajtuar edhe paditësi/ i kundër padituri. Shuma e lartcekur është shumë e llogaritur për punët e kryera deri tek shkëputje e kontratës ndërsa shuma prej 66,485.17 (gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë euro e shtatëmbëdhjetë cent) Euro është pjesa e mbetur e avansit të cilën është dashur t’ia kthejë paditësi/ i kundër padituri të paditurës/ kundër paditëses e që nuk është pajtuar ta bëjë.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështjet Ekonomike, pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin KE.nr.2473/22 të datës 01.02.2023, me të cilin në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar padinë e paditësit N.P.T.SH “Getoari” Sh.P.K me seli në Prizren, ashtu që është detyruar e paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që paditëses në emër të punëve të filluara përgatitore gjeodezike, dislokim të makinerisë, punëtorëve dhe punëve tjera përgatitore dhe në emër të punimeve të kryera në objektin e kontraktuar, materialeve të dërguara në emër të fitimit të humbur t’i paguaj borxhin në shumën prej 117,269.67 (njëqind e shtatëmbëdhjetëmijë e dyqind

e gjashtëdhjetë e nëntë Euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent) Euro, me kamatë vjetore 8% në vit, duke filluar nga data e ekspertizës së ekspertëve e datës 23.10.2017 e deri në pagesën definitive, e tërë kjo në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Në pikën II. të dispozitivit është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e kundër paditëses/ të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e kundër paditëses ashtu që të detyrohet paditësi N.P.T.SH “Getoari” Sh.P.K që të bëjë kthimin e shumës 66,485.17 (gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë Euro e shtatëmbëdhjetë cent) Euro në emër të pjesës së mbetur të avansit dhe atë me kamatë ligjore 8%. Ndërsa në pikën III të dispozitivit është detyruar e paditura/ kundër paditësja Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që t’ia kompensojë paditësit N.P.T.SH “Getoari” Sh.P.K shpenzimet procedurale në vlerë prej 6,169.00 (gjashtëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështjet Ekonomike, ka vërtetuar gjendjen faktike duke ardhur në përfundim se në mes të palëve ndërgjyqëse nga provat e administruara nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi/ i kundër padituri me të paditurin/ kundër paditësen kanë qenë në marrëdhënie kontraktuese; Kontrata për “Ndërtimin e Impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe industriale në Zonën Industriale në Drenas” e dt. 18.11.2009. Kontrata ishte shkëputur në mënyrë të njëanshme nga ana e të paditurit/ kundër paditësit përmes listës së distribuimit e lëshuar nga Drejtori i Zyrës së Prokurimit- Adem Krasniqi me të cilën e njofton paditësin/ të kundër paditurin për shkëputje të Kontratës për “Ndërtimin e Impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe Industriale në Zonën Industriale në Drenas” duke marrë parasysh rrjedhën e procesit të punës dhe pengesat e paraqitura edhe përkundër mundimit për zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe shterimit të mundësive që ky projekt të vazhdojë. Nga provat që gjendjen në shkresat e lëndës gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësit/ kundër të paditurit pas shkëputjes së njëanshme nga ana e të paditurës/ kundër paditëses i janë shkaktuar dëme deri në vlerën 117,269.67 Euro, të konstatuar nga ekspertët e cila ekspertizë në mënyrë të detajuar sqaron lartësinë e shumave, ka përmbajtje të qartë, prandaj nisur nga këto të dhëna gjykata ia kishte falur besimin një ekspertizë të punuar në mënyrë profesionale. Vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitën e Nenit 106 të LMD-së dhe Nenit 114 par. 1 të LMD-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerësoji se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkellje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, pasi që e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu në aktgjykimin e ankimuar nuk është bërë konstatimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata ankimore vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e Avokaturës Shtetërore lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës, në veçanti pretendimit se nuk janë vlerësuar provat e të paditurës. Ndonëse një pretendim i tillë është i përgjithësuar dhe nuk bazohet në pretendime konkrete, kolegji i kësaj gjykate sipas detyrës zyrtare duke i hetuar shkeljet esenciale, vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale qoftë të natyrës absolute apo relative, si shkaqe për prishjen e aktgjykimit. Sipas kolegjit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për themelësinë e kërkesëpadisë në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadisë së paditëses – kundër paditurës, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë e ka provuar përmes ekspertizave në të cilat janë dhënë arsye dhe sqarime të mjaftueshme e mbi të cilat nuk ka pasur vërejtje të tjera.

Sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se në rastin konkret palët kanë hyrë në një marrëdhënie kontraktuale-detyrimore të prokurimit (nr. MTI204/09/096/511 e lidhur ndërmjet Ministrisë së tregtisë dhe industrisë dhe NPTSH “Getoari” Sh.p.k) për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe industriale në zonën industriale në Drenas. Nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi ka vijuar punimet, ka realizuar pjesën e vet të detyrimit duke u vërtetuar me librat e punës dhe raportet e ndërtimit të cilat ishin mbajtur në mënyrë të rregullt nga paditësja. Sipas kontratës palët kanë marrë përsipër detyrimet e veta, ndër të tjera duke përcaktuar se rregullimi sa i përket sigurimit të vend ndërtimit i takon të paditurës më të cilën ishte përcaktuar se menaxheri i projektit me urdhër të punëdhënësit do të kërkoj nga kontraktuesi të bëjë sigurimin e vend ndërtimit me rastin e fillimit të punëve të kontraktuara. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar mbi bazën e shkresave të lëndës se lëshimet sa i përket mospërmbyshjes së kontratës kanë qenë në anën e të paditurës e cila me lëshimet e veta nuk ka arritur të siguroj vend punishten duke lëshuar të përmbush detyrimet e veta kontraktuale.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar gjendjen e fakteve sa i përket mospërmbyshjes së detyrimeve nga e paditura. Edhe për kolegjin është i qartë fakti se kontraktuesi “Getoari” Sh.p.k me rastin e përfitimit të kontratës në fillimi i është qas realizimit të projektit duke caktuar me vendim menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtes, të cilët kanë kontaktuar vazhdimisht me autoritetin kontraktues – MTI. Nuk ka qenë kontestues fakti se punët përgatitore dhe ndërtimore kanë filluar me vonesë 6 mujore pa fajin e paditëses për shkak të pengesave si: lokacioni i pa definuar mirë, mangësitë e projektit, pengesat e largpërçuesit dhe pengesat e banorëve lokal, të gjitha këto të evidentuara në ditarin e ndërtimit dhe shkresat zyrtare të adresuara tek punëdhënësi. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësi përkundër këtyre vështirësive, i ka dërguar makinat e rënda në punishte për kryerjen e punëve tokësore, përgatitjen e terrenit dhe ka dërguar në objekt një sasi të konsiderueshme të materialit

ndërtimor si: armaturë, pahi, drasa, shtafne, blloka, beton, ujë, mjete dhe inventar për punë etj. dhe fillon ndërtimin duke siguruar edhe rojën e punishtes për 24h.

Për Kolegjin e kësaj gjykate është evidente se lëshimet në mosrealizimin e punimeve kanë ekzistuar në anën e të paditurës, e cila nuk ka arritur të sigurojë vend punishten për shkak të ndërprerjes dhe kërcënimeve të përditshme në vazhdimësi nga banorët lokal. Ky fakt vërtetohet me raportin e gjendjes i dt. 29.06.2011, bërë nga menaxheri i projektit z. Flamur Lajqi. Pra qartë evidentohet në raportin e menaxherit të projektit se punimet në objektin e impiantit dhe rrugës deri tek impianti janë ndërprerë në vazhdimësi nga personi fizik H. Hoxha dhe që kryesi i punimeve nuk mund t'i zhvillojë punimet para pengesave dhe kërcënimeve të personit të lartpërmendur. Të gjitha këto prova kanë dëshmuar se paditësja ka kryer pjesën e vet të detyrimeve mirëpo për shkak të pengesave të pa parashikuara dhe pa fajin e paditëses, deri te ndërprerja e kontratës ka ardhur në mënyrë të njëanshme nga e paditura.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar një nga një të gjitha pretendimet ankimore sa i përket pretendimeve për vërtetimin e gjendjes faktike, mirëpo ka vlerësuar se asnjë nga pretendimet nuk gjen mbështetje qoftë faktike apo juridike.

Është evident fakti se kontrata në mënyrë të njëanshme dhe pa fajin e paditëses shkëputet nga e paditura përmes listës së distribuimit të dt. 28.02.2013, e lëshuar nga Drejtori i zyrës së prokurimit. Sipas këtij dokumenti e paditura e njofton paditësin/ të kundër paditurin për shkëputje të Kontratës për “Ndërtimin e Impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe Industriale në Zonën Industriale në Drenas” duke marrë parasysh rrjedhën e procesit të punës dhe pengesat e paraqitura edhe përkundër mundimit për zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe shterimit të mundësive që ky projekt të vazhdoje.

Pretendimi se shkëputja e kontratës ishte bërë në mënyrë të ligjshme nuk qëndron, pasi që në kushtet kontraktuale evidentohet qartë se mundësia e të paditurës/ kundër paditësit për shkëputje të kontratës është paraparë edhe me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së lartcekur në kuadër të pikës 10 që parasheh se në rast të paraqitjes së çfarëdo rrethane që e pamundëson përmbushjen e kontratës, rrethanë e cila paraqitet pa fajin e punëdhënësit dhe të punëmarrësit si pasojë e personave të tretë, Menaxheri Projektues me vendim të punëmarrësit do të ndërpres vazhdimin e kryerjes së punëve sa më shpejt që është e mundur, dhe do të bëhet vlerësimi i punëve të përfunduara.

Sidoqoftë, fakti i ndërprerjes së kontratës nuk parashihet pa pasoja kontraktuese për palën që e shkëputë kontratën. Kështu, me nenin 10 par.2 dhe Nenin 20 par.4 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës janë paraparë kushtet e kompensimit të pagesës në rast të ndërprerjes së kontratës. Siç u theksua, nga vet letër distribuimi i të paditurës nuk është kontestuese se kontrata ishte ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga e paditura për shkak të pengesave të paraqitura.

Se kontrata ishte ndërprerë pa fajin e paditëse vërtetohet nga vet pretendimet e të paditurës me ankesë, e cila thekson se “pas shumë takimeve me banorët e zonës nuk është arritur pajtueshmëri për vazhdimin dhe realizimin e projektit. Së këndejmi, është pa dilemë fakti se shkëputja e

njëanshme ka lindur për fajin e të paditurës, respektivisht pa fajin e paditëses dhe se të njëjtës i takon shpërblimi i dëmit konform Nenit 106 të LMD.

Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë korrekte të drejtën materiale, pasi që, e Nenin 106 të LMD-së parashihet se: *“Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vetë ligjit. Në çdo rast ka të drejtë në shpërblimin e dëmit”*.

Sipas Kolegjit, në rastin konkret, e paditura në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara në mënyrë shprehimore ndërpret njëanshmë kontratën ashtu që pa kërkuar respektivisht pa kërkuar përmbushjen e kontratës dhe për shkaqe jo-përmbajtësore të detyrimeve kontraktuese, e ka shkëputur kontratën dhe me këtë i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm paditësit/kunder të paditurit, të cilin dëm sipas dispozitave të Nenit 114 par. 1 të LMD-së, është i detyruar t'ia kompensojë.

Nuk qëndron pretendimi i të paditurës lidhur me interpretimin e KRPP dhe as memorandumit mes të paditurës dhe Komunës së Drenasit, si kusht për shkëputje të ligjshme të kontratës. Sepse, pengesat nga faktorët e jashtëm siç janë pengesat nga ana e banorëve nuk janë lëshime të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë për dëmin kontraktual të shkaktuar si pasojë e shkëputjes së njëanshme të kontratës. Interpretimi i KRPP nuk paraqet shkak ligjor për ta liruar të paditurën nga përgjegjësia kontraktuale. Ndërkaq, memorandumit i bashkëpunimit mes të paditurës MTI dhe Komunës së Drenasit është raport jashtëkontraktual mes të paditurës dhe palës së tretë dhe nuk ndikon në raportin detyrimor mes palëve. Sipas Kolegjit, të njëjtat nuk janë arsye për lirimin nga përgjegjësia kontraktuale, e as fakti se e paditura ka bërë përpjekje për vazhdimin e kontratës nuk është arsye për shmangie nga përgjegjësia për ndërprerje të kontratës.

Pretendimet e të paditurës me ankesë lidhur me kushtet objektive për ndërprerje qofshin ato edhe të ligjshme, e bëjnë palën kontraktuese përgjegjëse për shpërblimin e dëmit për shkak të ndërprerjes së njëanshme të kontratës, konform Nenit 106. Kjo për faktin se e paditësja ka filluar punimet, ka kryer punët përgatitore, ka dërguar makinat e rënda në punishte për kryerjen e punëve tokësore, përgatit dhe dërgon në objekt një sasi të konsiderueshme të materialit ndërtimor si: armaturë, pahi, drasa, shtafne, blloka, beton, ujë, mjete dhe inventar për punë etj. dhe fillon ndërtimin duke siguruar edhe rojën e punishtes për 24h. Madje, se paditësja ka kryer një pjesë të punimeve vërtetohet nga vet Raporti Përfundimtar i lëshuar nga Kompania Mbikëqyrëse “Plan-Kos” Sh.p.k, e angazhuar nga e paditura për mbikëqyrje dhe menaxhim të Projektit.

Së këndejmi, për Kolegjin e Dhomës së Shkallës së Dytë, është kontradiktor qëndrimi i të paditurës për dështimin e realizimit të projektit nga paditësja, kur merret parasysh se Raporti Përfundimtar i “Plan-Kos” ShpK ka evidentuar kryerjen e 2,635% të shumës së kontraktuar. Rrjedhimisht, e paditura ka pasur të drejtë për përmbushjen e dëmit në tërësi, dëm ky i cili së pari në kuptimin e dëmit material është vërtetuar me ekspertizën e ndërtimtarisë, e cila ka vlerësuar dëmin e shkaktuar për punët ndërtimore duke përfshirë realizimin e pranuar dhe

nënshkruar nga organi mbikëqyrës në vlerë 23,792.81 Euro dhe vlerën e materialit ndërtimor i cili është dërguar në punishte dhe është dëmtuar gjatë largimit dhe rikthimit nga punishtja në vlerë 37,955.62 Euro; të dyja këto duke i mbledhur, vlera totale është 61,748.43 Euro. Ndërkaq, në ekspertizën financiare është vërtetuar lartësia e pjesës tjetër të dëmit - fitimit të humbur dhe atë duke u bazuar në faktin që projekti është planifikuar për një kohëzgjatje prej 132 ditësh dhe është zvarrit përmbi 1000 ditë dhe në fund ka dështuar në tërësi, dhe sipas mendimit të ekspertëve fitimi i humbur duhet të jetë së paku në shkallë prej 12%. Kështu, eksperti financiar ka llogaritur dëmin material për pagat e punëtorëve në shumë prej 48,300.00 euro, si dhe shumën prej 97,500.21 euro për fitimin e humbur. Nga vlera totale e dëmit material për punimet e kryera dhe materialit në shumën prej 61,747.44 euro eksperti financiar ka llogaritur shumën prej 48.300 euro dhe 97.500.21 euro e cila jep vlerën 207,547.65 të cilës i është zbritur vlera prej 90.277.98 euro të cilën paditësja e ka pranuar si avans. Në këtë gjendje, paditësit sipas ekspertizës i është llogaritur dëmi total prej 117.269.67 euro.

Lidhur me pretendimet e të paditurës për mungesën e dëmit për fitim të humbur e në veçanti sa i takon pagave të punëtorëve, Kolegji çmon se në ri procedurë gjykata në bazë të provave ka vërtetuar drejtë faktet kur kemi të bëjmë me dëmin material sa i përket pagesës së punëtorëve dhe atë me ekspertizën plotësuese paditësi ka siguruar prova lidhur me numrin e punëtorëve dhe vlerën e pagesave në bazë të raporteve të deklaruara në ATK. Se paditësi ka pasur dëm material për shkak të pagesës së punëtorëve vërtetohet në riprocedurë edhe nga plotësimi i ekspertizës financiare të ekspertit Ali Gagica, i cili ka sqaruar në ri-procedurë në mënyrë të detajuar lidhur me vërejtjet rreth pagesës së punëtorëve. Këto sqarime gjykata e shkallës së parë i ka mbështetur në deklaratat e punëtorëve të paditësit Getoari SHPK, si dhe në deklarata e paditësit e dt. 10.04.2018 ku ka deklaruar listat vjetore të punëtorëve të punësuar. Në shkresat e lëndës paditësi ka bashkangjitur të gjitha listat e pagesave të punëtorëve, deklaratën për vizitë të ATK, Raportin Sqarues të ATK të datës 08.05.2018, pasqyrat financiare dhe deklaratimet tatimore. Sipas Kolegjit të njëjtat janë dokumente të mjaftueshme për të ndërtuar ekspertizën e cila vlerëson dëmin material në emër të pagesave të punëtorëve dhe nuk mundte të kundërshtohet apriori si e pabazë nën pretekstin se paditësi nuk ka mundur të ketë të gjithë punëtorët të angazhuar në projekt. Për Gjykatën, paditësi ka bartur barrën e të provuarit për të siguruar prova rreth nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare dhe kontestimi i saj përkundër dëshimit me prova zyrtare të ATK nuk mund të mos përfilllet vetëm për shkak të kontestimit apriori nga e paditura.

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me dëmin material në emër të materialit të humbur ndërtimor në shumë prej 61,747.44€, Kolegji çmon se aktgjykimi nuk përmban vërtetim të gabuar të fakteve. Nga vlerësimi i aktgjykimit dhe pretendimeve ankimore qartë evidentohet se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të bazuara për vlerësimin e dëmit material dhe atë në përgjithësi për punët ndërtimore. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar mjaftueshëm faktin se shuma prej 61,747.44€ i takon dëmit të përgjithshëm ku përfshihet kategoria e realizimit të punimeve dhe të pranuar nga kompania mbikëqyrëse “Plan Kos”, në shumë prej 23,792.81€ si dhe vlera e materialit ndërtimor të dërguar në punishte në shumë prej 37,955.62€. Së këndejmi, dëmi në shumën e përgjithshme prej 61,747.44€ i referohet totalit të dëmit material të vlerësuar nga eksperti i ndërtimtarisë sipas ekspertizës së Majit 2017. Kjo ekspertizë është bazuar në Ditarin Ndërtimor dhe Librit të Ndërtimit e që sipas ekspertit është

pranuar me raportin përfundimtar të Organit Mbikëqyrës me datë 15.05.2014. Nga shkresat e lëndës gjykata vëren se e paditura e ka kontestuar ekspertizën financiare duke kërkuar sqarime në seancën e datës 17.05.2018. Mirëpo, e paditura ekspertizën e ndërtimtarisë nuk e ka kontestuar në shumën prej 23,792.98€, por e ka kundërshtuar në “pjesën tjetër të llogaritur në emër të armaturës së mbetur në punishte”. Kështu ekspertiza e ndërtimtarisë përpos kontestimit në këtë pjesë, nuk është kërkuar kthim në plotësim, apo sqarime shtesë. Si rrjedhojë gjykata në tërë vijimin e procesit është marrë ekspertizën financiare sa i përket pagave, duke detyruar paditësen të sjell prova shtesë për listat e pagave të punëtorëve.

Ndonëse e paditura me ankesë nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me pikën II të aktgjykimit me të cilën ishte refuzuar kundërpadia e të paditurës – kundërpaditëses, gjykata e shqyrtoi edhe këtë pjesë të aktgjykimit lidhur me shkeljet eventuale të dispozitave të procedurës të cilat gjykata i heton sipas detyrës zyrtare. Mirëpo, kolegji gjeti se edhe në këtë pjesë aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje absolute, të cilat janë kusht për prishjen e eventuale të aktgjykimit. Më tej, kjo Gjykatë vlerëson se arsyet e dhëna në aktgjykim janë të mjaftueshme sa i takon pjesës refuzuese dhe se me faktin se gjykata e shkallës së parë me prova ka vërtetuar shkaktimin e dëmit në anën e palës paditëse, rrjedh se e paditura nuk ka bazë për të kërkuar kthimin e pjesës së mbetur të avansit.

Nga të lartcekurat rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar me ankesë.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallë së Dytë i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të autorizuarës së paditësit, por ka gjetur se të njëjtat kanë qenë të pabazuara, të pa argumentuara dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallë së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 para. 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.656/2023, me datë 13.02.2025

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova